



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve - Ministarstvo Finansija, Rada i Trasfera
Ministry of Finance, Labour and Transfers



Dogana e Kosovës – Carina Kosova – Kosovo Customs

Njoftim në lidhje me vlerën e tatueshme të arit të përpunuar

Të nderuar tatimpagues!

Dogana e Kosovës ju njofton, se një pjesë e artikujve të importit, atyre të prodhimit vendas, apo të disa shërbimeve, lirohen nga tatimi doganor dhe TVSH-ja. Këto lirime përfshijnë edhe një pjesë të metaleve të çmuara, bazuar ne kuadrin ligjor në fuqi.

Furnizimi i arit të përpunuar

Në vlerën e tatueshme të arit të përpunuar të importuar dhe arit të përpunuar të furnizuar brenda vendit, nuk përfshihet vlera e arit të përdorur si lëndë e parë, bazuar në Ligjin Nr. 04/L-163, datë 26 dhjetor 2013 “Për mallrat e liruar nga tatimi doganor dhe mallrat me tarifë zero të tatimit doganor”, Udhëzim Administrativ (QRK) nr.07/2016 datë 12 prill 2016 për ndryshimin dhe plotësimin e udhëzimit administrativ nr. 05/2015 ”Për mallrat e liruar nga tatimi doganor”, Ligji Nr. 05/L -037, datë 22 korrik 2015 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar” në Republikën e Kosovës si dhe Udhëzimi Administrativ (MF) Nr. 05/2016 datë 15 korrik 2016 “ Për skemën e veçantë për arin e investueshëm”

Mirëpo, në vlerën e tatueshme të një importi apo furnizimi brenda, përfshihen përbërës materialë të tillë si:

- 1.argjendi,
- 2.gurë të çmuar,
- 3.lëndë plastike,
- 4.vlera e punës, përbërës të ngjashëm, etj.

Drejtoria e Doganës, Lagjja Kalabri, Rr. Rexhep Krasniqi 10.000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel & Fax (+383 38) 540 350 /540 836

www.dogana-ks.org

Legurave të sipër cekura mund ti shtohen edhe metale tjera. Prodhuesi i punimeve nga metalet e çmuara ka për detyrë, që me rastin e paraqitjes së deklaratës doganore për punimet e kreut 7113 të deklaroj me faturë, përmbajtjen e metaleve që bëjnë pjesë në legurën e metalit të çmuar dhe përqindja e arit të pastër të jetë e ndarë me përshkrim dhe përqindjen e pjesëmarrjes në legurën e përpunuar.

Pastërtia e arit të punimet e punuara prej legurës së këtyre metaleve, paraqet pjesëmarrjen e masës së metalit të çmuar(m1) ndaj masës së tërësishme(m2) të atij punimi, e shprehur me të mjtat pjesë

$$p = (m1 / m2) \cdot 1000$$

Lënda e parë ar e përdorur për prodhimin e bizhuterive më të mira dhe më të shtrenjta, matet dhe konvertohet në ar me përmbajtjen me të lartë të arit më të pastër në të 999.9 për qind, ose ar 24 karat.

Një lëndë e tillë me përbërjen e arit kimikisht më të pastër është e kuotuar në bursë, nga ku dhe përcaktohet çmimi i tij. Ndërsa për kushtet e përpunimit, lidhja që bëhet midis arit të përdorur si lëndë e parë dhe metaleve të tjerë të çmuar, krijon kategori të ndryshme ari, që dallohen nga njëra-tjetra nga përqindja e pastërtisë.

Në këtë mënyrë hyn në përdorim cilësia standarde e vlerësimit të pastërtisë së arit që është “karati” që nis nga ari më i papastër 8 karatësh ose i vlerësuar me 333.0 përqindje pastërtie, deri tek ari maksimalisht i pastër 24 karatësh, ose 999.9 për qind pastërti. Cilësitë standarde më të përdorshme të arit janë:

8 karat - 333/000
9 karat - 375/000
14 karat - 585/000
18 karat - 750/000
21 karat - 875/000
24 karat - 999,9/000.

Cilësia e arit e shënuar në faturë

Në çdo bizhuteri është e stampuar edhe shifra “për mijë” e arit të pastër në të. Kjo shifër detyrimisht paraqitet në faturën e importit. Nëse numri i stampuar është 750, atëherë lidhja është klasifikuar 18 karat dhe përmban 7,50 gram ar të pastër në 10 gram të lidhjes gjithsej.

Vlera për qëllime doganore e arit të përpunuar të importuar

Vlera për qëllime doganore për arin e përpunuar, të importuar, përcaktohet në përputhje me legjislacionin doganor dhe legjislacionin tatimor në Republikën e Kosovës.

Vlerës së tatueshme, i zbritet vetëm vlera e arit të përdorur si lëndë e parë. Dokument bazë justifikues është fatura e shitësit të huaj, lëshuar në adresë të blerësit vendas.

Gjatë deklarimit në doganë, ari i pastër në fatura paraqitet veçmas dhe konvertohet në valutë. Kjo vlerë nuk përfshihet në vlerën e tatueshme të importit dhe zbritet nga vlera gjithsej e arit të importuar. Mbi vlerën e mbetur bëhet përlllogaritja e detyrimeve doganore, sipas procedurave të zakonshme të zhdoganimit.

Për vëmendje!

Mungesa e një ndarje të tillë të vlerës së një furnizimi, nuk i jep të drejtën importuesit për të mospërfshirë në vlerën doganore të tatueshme të importit, vlerën e arit të përdorur si lëndë e parë.

Dogana e Kosovës për llogaritjen e bazës së tatueshme për arin e përpunuar të importuar përdor kursin e këmbimit të arit të publikuar në “COIN App”

Shembull : Në Doganën e Kosovës paraqitet importuesi A për të deklaruar e zhdoganuar bizhuteri me bazë ari.

Në faturën që ai disponon që ja ka lëshuar shitësi i huaj, shënohet:

Sasia - 3 000 gr. bizhuteri, - nr. stampuar - 585 (14 karat).

Llogaritja e vlerës së tatueshme bëhet si më poshtë:

- Konvertimi i sasisë së bizhuterive të importuara në ar të pastër:

$3\,000 \times 0,585 = 1\,755$ gr. ar i pastër, sasi e cila në faturë paraqitet veçmas edhe e shprehur në valutë.

Kjo vlerë nuk përfshihet në vlerën e tatueshme të importit dhe zbritet nga vlera gjithsej e arit të importuar. Mbi vlerën e mbetur, bëhet taksimi në doganë për efekt të tatimit doganor dhe TVSH-së, sipas procedurave të zakonshme të zhdoganimit.

TVSH e zbatuar mbi vlerën e mbetur deklarohet si e zbritshme nga A.

II. Vlera e tatueshme e arit të përpunuar të furnizuar brenda vendit

Vlera e furnizimit brenda vendit është sa pagesa e plotë e atij furnizimi. Vlera e tatueshme e arit të përpunuar, të furnizuar brenda vendit, llogaritet, duke zbritur nga pagesa e plotë e furnizimit, vlerën e arit të përdorur si lëndë e parë.

Dokument bazë justifikues është fatura e furnizuesit, person i tatueshëm, e lëshuar në adresë të blerësit, e cila paraqet të ndarë veçmas vlerës totale të furnizimit, vlerën e arit të përdorur si lëndë e parë.

Për vëmendje!

Mungesa e një ndarjeje të tillë të vlerës së një furnizimi brenda vendit, nuk i jep të drejtë furnizuesit që të mos përfshijë në vlerën e tatueshme të furnizimit, vlerën e arit të përdorur si lëndë e parë

Pavarësisht natyrës së furnizimit, me shumicë apo me pakicë dhe pavarësisht vlerës së furnizimit, nga furnizuesi person i tatueshëm, lëshohet faturë tatimore siç përcaktohet në nenin 45 të Ligjit Nr. 05/L -037 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”.

Shembull: *Personi i tatueshëm A ushtron veprimtarinë ekonomike në fushën e përpunimit dhe tregtimit me shumicë të bizhuterive.*

Klienti i tij B është njëkohësisht person i tatueshëm që ushtron veprimtarinë në fushën e shitjes me pakicë të bizhuterive e artikujve të tjerë të luksit.

B porositi dhe blen tek A, disa artikuj bizhuterie me bazë ari, me sasi - 700 gr. dhe nr. stampuar - 750 (18 karat).

- Konvertimi i sasisë së bizhuterive të furnizuara në ar të pastër:

700 x 0,750 = 525 gr. ar i pastër.

- Kursi i publikuar nga BQK është:

1 gr.ar i pastër = 20.00 €

- Vlera e arit të përdorur si lëndë e parë.

- 525 x 20.00 =€

III. Aplikimin e procedurave në “ASYCUDA WORD” për përcaktimin e vlerës së tatueshme të arit të përpunuar

Në sistemin Asycuda Word, është krijuar kodi shtesë nacional “ARI” për rubrikën 37 pjesën e dytë për kreun 7113 të kapitullit 71 të Nomenklaturës së Kombinuar të Mallrave .

- a) Rasti i parë me kodin shtesë 000, përfaqëson rastin kur shifra “për mijë” e arit të pastër (pra ekuivalenti në karat) nuk është e shprehur në faturë dhe/ose mungon si stampë. Në këtë rast, vlera e arit të pastër e përdorur si lëndë e parë do të përfshihet në vlerën e tatueshme që merret si bazë për llogaritjen e detyrimeve doganore.

Në këtë rast, nuk ka ndryshim të mënyrës së llogaritjes së bazës së tatueshme dhe ajo do të llogaritet njëllë si për të gjithë mallrat e tjera.

- b) Rasti i dytë me kodin shtesë nacional ARI, përfaqëson rastin kur shifra “për mijë” e arit të pastër (pra ekuivalenti në karat) është e shprehur në faturë dhe paraqitet si stampë. Në këtë rast, vlera e arit të pastër e përdorur si lëndë e parë nuk do të përfshihet në vlerën e tatueshme që merret si bazë për llogaritjen e detyrimeve duke krijuar dy emërtime , ne emërtimin e parë paraqitet vlera e arit të pastër me përshkrimin përqindja e arit të pastër

Drejtoria e Doganës, Lagjja Kalabri, Rr. Rexhep Krasniqi 10.000 Prishtinë, Republika e Kosovës

Tel & Fax (+383 38) 540 350 /540 836

www.dogana-ks.org

dhe përdoret kodi shtesë ARI në rubrikën 37 ku lirohet nga taka Doganore 10 % dhe TVSH-ja, vetëm për përqindjen e shprehur në faturë ndaras, ndërsa në emërtimin e dytë përfshihet ndryshimi i çmimit të produktit si tersi me atë të përqindjes së arit të pastër.

Vërejtje: Në deklaratën Doganore, në rubrikën 41 të plotësohet me peshën e përqindjes së arit të pastër për llojin përkatës të arit.

Kur në faturë kemi të shprehur qartë ndarjen e përqindjes së arit të pastër me lloj dhe vlerë të mallit ndaj peshës dhe vlerës së mbetur të bizhuterisë, krijohen dy kode tarifore për një lloj të arit varësisht pastërtisë.

Për çdo paqartësi, pyetje apo informacion të nevojshëm ju mund të kontaktoni Qendrën e Thirrjeve ne Doganë në numrin + 383 – 38 540 350 apo shkruani ne info@dogana-rks.org.

25/11/2022
Prishtinë